

**KOMISIONI VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË
PALUAJTSHME TË KOMUNËS SË FERIZAJT**

Nr. 01-95
Datë: 26.04.2024

Në bazë të nenit 3 paragrafët 1 nën-paragrafët 2,3,11 neni 6 paragrafi 1 si dhe të nenit 8 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10 e datës 03 Prill 2019), për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1, Nën-paragrafi 1.2, neneve 8, 9, 10, 11 dhe 12 të Rregullores së Qeverisë së Kosovës Nr. 09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, e në zbatim të Vendimit Paraprak të Kuvendit të Komunës 01. Nr. 11 të dt. 31.01.2024, për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër lokalit afarist me nr. O-72217092-155-2-4-0 me sipërfaqe 59 m², Z.K. Ferizaj si dhe në zbatim të përgjegjësive sipas Vendimit të Kuvendit të Komunës, 01. Nr. 12, të dt. 29.02.2024, për themelimin e Komisionit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, Komisioni Vlerësues në mbledhjen e mbajtur me datën 26.04.2024, vendos për shpalljen:

ANKAND PUBLIK

Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër, të pronës komunale në shfrytëzim afatshkurtër.

1. **IPET** në shfrytëzim afatshkurtër, prej **15 vite**, lokali afarist me nr. O-72217092-155-2-4-0 me sipërfaqe 59 m², Z.K. Ferizaj, me adresë në rrugën “Dëshmorët e Kombit”, Ferizaj, pronë e Komunës së Ferizajt.

2. **Çmimi fillestar për 1m² është 5 (pesë) Euro, çmimi është mujor, fitues shpallet ofertuesi me çmimin më të lartë, nëse tërhiqet ofertuesi i par ankandi do të anulohet dhe rishpallet rishtaz.**

3. **Kriteret për vlerësimin e ofertave**

- Vlera e çmimit më të lartë të ofruar nga ofertuesi

4. **Të drejtat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve në Ankandin Publik**

Pjesëmarrësit në këtë proces kanë të drejtë;

- Të informohen me procedurat e ankandit publik;
- Të shohin pronën - hapësirën që jepet në shfrytëzim;
- Të tërhiqen nga konkursi jo më vonë se tre (3) ditë para hapjes së ofertave;
- Në rast se përfituesi i parë tërhiqet ankandi do të anulohet dhe rishpallet rishtaz si dhe do të ekzekutohet garancioni bankar në favor të Komunës së Ferizajt.

5. **Veprimtaria që mund të ushtrohet**

Veprimtari që mund të ushtrohet duhet të jetë e lejuar sipas normave morale, ligjore dhe rregullave tjera që parashihen me ligj. Veprimtaritë të cilat cenojnë rendin juridik dhe moral si dhe janë pengesë për banorët nuk do të epët prona në shfrytëzim, po ashtu përfituesi është i obliguar të pajiset me leje ndërtimore.

6. Dokumentet e nevojshme për Aplikim

- Fletë aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar;
- Letërnjoftimi kopje;
- Çertifikata e regjistrimit të biznesit, (për subjekte juridike);
- Garancioni bankar në shumë prej 3,000.00 €.

7. Ankandi Publik do të jetë i hapur për 15 ditë kalendarike:

- Nga data **26.04.2024** deri me datën **11.05.2024** ora **16.00**.
- Ankandi Publik do të jetë në ueb-faqe të Komunës së Ferizajt, tabelën shpalljeve të Komunës dhe në një gazetë ditore),
- **Oferta duhet të dorëzohet në zarfë të mbyllur dhe me ngjyrë të bardhë pa asnjë shenjë identifikuese, në të cilin duhet të shënohet numri i lokalit për të cilën aplikohet.**
- Hapja publike e Ofertave bëhet datën **14.05.2024** në ora **10.00**, në sallën e Kuvendit të Komunës.

8. Tërheqja e aplikacioneve-kopje fizike dhe elektronike, mund të bëhet në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve në Hyrje të Komunës së Ferizajt, çdo ditë pune prej ora 08.00 deri në ora 16.00.


9. Dorëzimi i ofertave bëhet në formë të mbyllur në Qendrën për Shërbim me Qytetar, e cila protokollohet si e tillë.

10. Të interesuarit mund të informohen(çdo ditë pune) përmes:

- Ueb faqes <http://kk.rks-gov.net/ferizaj/>
- Telefonit: **038/200/46-076**
- E-mail adresës: **info.ferizaj@rks-gov.net**

Kryesuesi i Komisioni Vlerësues i Ofertave


Sabri Murseli





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada-Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: FERIZAJ Nr. i njësisë kadastrale: 0-72217092-155-0
Zona kadastrale / Katastarska zona: Ferizaj Numri i lëndës / Broj predmeta: /2024
Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice: Objekt Shkalla e zvoglimit / Razmera plana: 1:500



Sipërfaqja e llogaritit e Lokalit O-72217092-155-2-4-0

- Ngjyra e kuqe me sip. 59.00m² Bruto
- Ngjyra e kaltër me sip. 43.80m² Neto

Lista e koordinatave, kodi dhe përshkrimi i tyre /
Lista koordinata, kod i njihov opis

1	7512481.942	4692165.573
2	7512475.853	4692170.781
3	7512470.972	4692165.284
4	7512477.016	4692160.054

Rilevot / Snimito: Mehmet Mehmeti
(emri dhe mbiemri i gjeodetit/kompanisë)

Nr. i licencës / Br. licence: _____

Nënshkrimi / Potpis: _____

Aprovot / Usvojto: _____
(emri dhe mbiemri i personit zyrtar)

Nënshkrimi / potpis: _____

Data e aprovimit / datum usvajanja: _____

V.V